

UDHËZUES për
mbrojtje të VIKTIMAVE të

**TRAFIKIMIT me
QENIE NJERËZORE**



mund 2017, Shkup

UDHËZUES

mbrojtje të VIKTIMAVE të

TRAFIKIMIT me

QENIE NJERËZORE

Botues:

Shoqata për Emancipim, Solidaritet
dhe Barazi të Grave - ESB

Rr. Maksim Gorki Nr. 20-1-4, Shkup

T. 02 3298 295; 3298 296

F. 02 3211 453

www.esem.org.mk



Studimi është financiarisht i mbështetur nga:





Për udhëzuesin...

Udhëzuesi për viktimat e trafikimit të qenieve njerëzore është pjesë e një serie të udhëzuesëve për gratë viktimat të dhunës, të përgatitura në kuadër të Projektit të USAID-it për mbrojtje ligjore të grave. Projekti i USAID për mbrojtje ligjore të grave po realizohet nga Shoqata për emancipim, solidaritet dhe barazi të Grave - ESB, në bashkëpunim me "Porta e hapur" Maqedoni - La Strada dhe Koalicionit "Të drejtat seksuale dhe shëndetësore të komuniteteve të marginalizuara", dhe përfshin tre komponenta kryesore: përmirësimi më proceset gjyqësore duke vepruar në rastet e lidhura me dhunë dhe diskriminim ndaj grave; avancimin e kuadrit ligjor që mbrojnë viktimat e dhunës dhe diskriminimit dhe promovimin e punës së organizatave të shoqërisë civile të cilat ofrojnë ndihmë ligjore për gratë viktimat të dhunës dhe diskriminimit.

Ende vlerat aktuale patriarkale dhe paragjykimet në lidhje me rolin e gruas në familje dhe në shoqëri janë një faktor thelbësor që kontribuojnë për tolerancë dhe për të minimizuar dhunën me bazë gjinore, si dhe kërkimi i fajit dhe përgjegjësisë për vetë viktimat e dhunës. Për fat të keq shumë prej këtyre pikëpamjeve janë të përfaqësuar edhe te përfaqësuesit e institucioneve, prandaj mungesa e besimit se mbështetja dhe mbrojtja e viktimave të dhunës do të sigurohet sipas të duhurës, në kohë dhe me cilësi. Gjithashtu viktimat e dhunës nuk janë të informuar ashtu si duhet në lidhje me të drejtat dhe mundësitë e tyre në dispozicion për t'i mbrojtur ato nga dhuna. Për këto arsye kemi ndjerë se në procesin për të ndihmuar dhe mbështetur viktimat e dhunës kërkohet një informim dhe inkurajim i tyre i vazhdueshëm.

Udhëzuesit janë të përgatitur në bazë të përvojës që kanë pasur viktimat e dhunës në familje apo të trafikimit me njerëz dhe të punëtorëve të seksit nga aspekti i qasjes në institucionet shtetërore dhe mbrojtjes që ju është ofruar.

Ne shpresojmë se Projekti i USAID për mbrojtje ligjore të grave përmes udhëzuesëve të përgatitur do të kontribuojnë në rritjen e ndërgjegjësimit për mekanizmat ligjorë për mbrojtjen e viktimave dhe më tej t'i inkurajon ato që të përdorin këto masa mbrojtëse për të parandaluar dhunën.

Udhëzuesi për mbrojtjen e viktimave të trafikimit të qenieve njerëzore është për të gjithë ata që kanë vuajtur shfrytëzim dhe trafikim. Kryesisht ai ka për qëllim të ofrojë informacion të detajuar në lidhje me shërbimet dhe burimet që janë në dispozicion për shërim të suksesshëm. Gjithashtu ky Udhëzues përmban një shpjegim të fenomenit të trafikimit me qenie njerëzore, si dhe udhëzime për vetëidentifikimin më të lehtë.

Trafikimi i qenieve njerëzore është një problem serioz ndërkombëtar që është një formë moderne e skllavërisë. Në procesin e trafikimit në mënyrë më të egeër bëhet shfrytëzimi i trupit dhe punës të njeriut me të cilin viktimave ju shkelet e drejta e jetës, lirisë, shëndetit, punës, arsimit, dhe të sigurisë. Viktimat e trafikimit me qenie njerëzore mund të jetë çdo burrë, çdo grua, çdo fëmijë, pavarësisht nga mosha, arsimit apo përkatësisë fetare të cilët individualisht apo kolektivisht kanë pësuar dhunë fizike, psikologjike dhe seksuale, shfrytëzim dhe vuajtje emocionale. Me nënshkrimin dhe miratimin e Protokollit për Parandalimin, Shtypjen dhe Ndëshkimin e Trafikimit të Personave, veçanërisht Grave dhe Fëmijëve (Protokolli i Palermos) në vitin 2000 përcaktoi një përkufizim dhe definim të përbashkët përgjithësisht të pranuar të asaj që përbën trafikimi.

Trafikimi i qenieve njerëzore është një fenomen i pranishëm edhe në vendin tonë, i cili është jo vetëm një vend transit, por edhe vend i origjinës. Legjislacioni ynë në Kodin Penal rregullon veprën e trafikimit si vijon: *“Çdo person i cili me forcë, kërcënime serioze mashtron ose merr forma të tjera të shtrëngimit, rrëmbimit, mashtrimit, shpërdorimit të pozitës ose të shtatzënisë, dobësisë, ose paaftësinë fizike dhe mendore, ose me dhënien apo marrjen e parave ose përfitimeve të tjera për të arritur pëlqimin e një personi që ka*

¹ Protokoll i Kombeve të Bashkuara për Parandalimin, shtypjen dhe ndëshkimin e Trafikimit të Personave, veçanërisht grave dhe fëmijëve që plotësohet me Konventën e Kombeve të Bashkuara kundër Krimit të Organizuar Ndërkombëtar.

² Protokoll i Palermos përkufizon trafikimin njerëzor si “Rekrutimi, transportimi, transferimi, strehimi ose pranimi i personave me anë të kërcënimit ose përdorimit të forcës apo formave të tjera të shtrëngimit, rrëmbimit ose mashtrimit ose abuzimit të pushtetit ose të një pozite dobësie ose dhënies apo marrjes së pagesave ose përfitimeve për të arritur pëlqimin e një personi që ka kontroll mbi një person tjetër për qëllime shfrytëzimit të tij/saj. Shfrytëzimi përfshin, në minimum, shfrytëzimin e prostitucionit të të tjerëve ose formave të tjera të shfrytëzimit seksual, punë të detyruar ose shërbim të detyruar, robëri apo të kryer të ngjashme me skllavërinë, të robërimit ose të heqjes së organeve.

kontroll mbi personin ose ndryshe rekruton, transporton, bart, blen, shet, strehon ose pranon persona për eksploatim të prostitucionit ose formave të tjera të shfrytëzimit seksual, punë të detyruar ose në robëri, skllavëri, martesë të detyruar, shtatzëni të detyruar, adoptim të paligjshëm apo marrëdhënie të ngjashme, lypje apo shfrytëzim, ose veprimtaria që ligji parandalon ose transplantim të paligjshëm të organeve njerëzore, do të dënohet burgim për të paktën 4 vjet."

Përcaktimi i termit trafikim përfshin procedurat dhe veprimet nëpërmjet të cilave bëhet trafikimi, duke përfshirë: **rekrutim, transportim, transferim, blerje, shitje, pranim apo strehim**. Për të detyruar njerëzit për të kryer aktivitete me ngurrje, trafikantët përdorin: **përdorimin e forcës, kanosje serioze ose forma të tjera të shtrëngimit, rrëmbimit, mashtrimit, keqpërdorimit të fuqisë apo pafuqisë ose marrjen e parave ose përfitime të tjera**. Qëllimi i kryerjes së të gjitha aktet nga shitësit është shfrytëzimi i të tjerëve për fitim. Eksploatimi, i cili është një element thelbësor i veprës së trafikimit të personave kryhet në mënyra të ndryshme: **shfrytëzimi seksual, shfrytëzimi për punë, lypje të detyruar, detyrim për të kryer krime, adoptimin e paligjshëm, martesa e detyruar ose tregëti me organe**.



2. Format e Trafikimit

SHFRYTËZIMI SEKSUAL

Viktima të shfrytëzimit seksual janë kryesisht gra dhe vajza. Përveç prostitucionit të detyruar, i cili zakonisht është i pranishëm, kjo formë e shfrytëzimit mund të përfshijë përdorimin për qëllime pornografike apo shfrytëzim përmes shërbimeve seksuale online.

PUNË E DHUNSHME

Kryesisht viktimat të këtij lloji eksploatimi janë burra që punojnë në industrinë e ndërtimit, por edhe shfrytëzimi është shumë e përhapur në sektorin e bujqësisë, industrisë, tekstile dhe hotelieri. Puna e detyruar përfshin punë kundër vullnetit të personit që është duke punuar në kushte që një person nuk i ka pranuar, si dhe punë në punët e shtëpisë (nënshtrim).

LYPJE E DETYRUAR

Lypja e detyruar poshtu mund të jetë një nga format e trafikimit të qenieve njerëzore në të cilët janë përfshirë fëmijë të pambrojtur dhe të rritur si dhe njerëzit me rrezik të lartë me probleme fizike dhe mendore dhe aftësi të kufizuara. Kjo formë e shfrytëzimit kyq dhe gjymtimin e qëllimshëm trupor dhe detyrim të pretendimit të aftësive të kufizuara për të marrë më shumë para nga lypja.

SHTRËNGIMI PËR TË KRYER VEPRA PENALE

Viktimat mund të shfrytëzohen përmes përfshirjes së detyruar në aktivitete kriminale. Kryerja e krimit nën presion shpesh nuk njihet si një formë e trafikimit të qenieve njerëzore dhe për këtë arsye një pjesë e madhe e viktimave janë më shpesh të dënua për këtë krim, edhe pse është bërë nën presion.

MARTESAT E DETYRUARA

Kjo formë e trafikimit përfshin rekrutimin e fëmijëve nga prindërit, të afërmit dhe të tjerët për “martesa” jashtë vendit, përmes premtimeve të rreme dhe mashtrime për një jetë të mirë. Viktimat e këtij shfrytëzimit janë të prekshëm për shumë lloje të shfrytëzimit nga ana e familjeve të të cilëve ata janë shitur, sidomos shfrytëzimit seksual, lypjes, kryerje të vjedhjeve dhe servitutit.

TREGËTI ME ORGANE

Heqja e pjesëve të trupit të njeriut (të gjakut, veshkat, qelizat vezë, indet, etj) dhe shitjen e tyre kundër vullnetit të personit ose duke marrë fëmijën larg nga nëna për shitjen e organeve është gjithashtu një formë e trafikimit të qenieve njerëzore.

Pavarësisht se çfarë forme e shfrytëzimit kjo është ajo që është e përbashkët për të gjithë është se ajo gjithmonë realizohet në kushte shumë të vështira dhe çdo gjë që merr viktimën në trafikim është kundër vullnetit të saj/tij dhe nën presion.

3.

Shenjat për të njohur se a jeni një viktimë

- Shenja e parë që ju të ndiheni të mbyllur ose të rrëmbyer. !
- Ju merret pasaporta dhe dokumentet tjera personale. !
- Jeni të detyruar për të përdorur një identitet të rremë (pasaportë ose kartë identiteti të një personi tjetër). !
- Jeni të detyruar të punoni apo bëni diçka që ju nuk dëshironi të bëni. !
- Jeni të detyruar që të ofroni shërbime seksuale për klientët. !
- Përdorni trupin tuaj për pornografi, trafikim organesh, kontrabandën e drogës dhe tjera. !
- Jeta juaj është në rrezik për shkak të një tjetër. !
- Në qoftë se ju nuk jeni dakord për të bërë atë që pritet nga

ju, ju përjetoni dhunë fizike, psikologjike ose seksuale (rrahje, përdhunim, uri, frikësim, etj).

- Lëvizjet tuaja janë të kufizuara dhe të kontrolluara, ndjekin çdo gjë që ju bëni apo thoni.
- Gjithmonë ju shoqërojnë kur shkoni jashtë.
- Ju nuk jeni të lejuar në qasje në komunikim (telefon, internet, etj).
- Ata kërcënojnë të dëmtojnë familjen tuaj.
- Në martesë je kundër vullnetit tend dhe ndjen se bashkëshorti juaj ose familja e tij/saj të keqpërdorin.

4.

Çfarë duhet të ndërmerri për t'u mbrojtur

Nëse ju jeni një viktimë e trafikimit të qenieve njerëzore, ka disa hapa që ju mund të merrni në mënyrë për të siguruar mbrojtjen tuaj.

Raportim i akteve të trafikimit

Raporto akte të trafikimit të qenieve njerëzore në stacionin më të afërt policor. Pas regjistrimit tuaj në stacionin e policisë, zyrtari policor është i detyruar të thërrasë një inspektor i cili është i specializuar në trafikimin e qenieve njerëzore. Deklarata juaj duhet të përfshijë një përshkrim të detajuar të veprimeve që kanë ndodhur. Disa nga çështjet që do të vendosen janë personale. Dëshmia juaj do të regjistrohet nga inspektori dhe duhet të firmosni pasi të keni lexuar atë ose ai e ka lexuar për juve.

Periudha e reflektimit

Nëse pas intervistës fillestare me policinë nuk ndiheni të gatshëm për të ndarë informacione nga vuajtjet tuaja, mund t'ju jepet një periudhë reflektimi për t'u shëruar dhe vendosë nëse doni të bashkëpunoni me autoritetet kompetente. Periudha e vendimit është deri në dy muaj, dhe në qoftë se ju jeni një fëmijë (nën 18 vjeç), kjo periudhë mund të zgjatet.

Nëse ju jeni një shtetas i huaj dhe vendosni të bashkëpunoni me autoritetet kompetente, pas periudhës së vendosjes ju mund të merrni një leje të përkohshme qëndrimi. Leja e përkohshme e qëndrimit për të huajt lëshohen për gjashtë muaj me mundësi vazhdimi edhe për gjashtë tjera. Gjatë vendimit ju ofrohen shërbimet e mëposhtme: strehim të përshtatshëm dhe të sigurt; të kujdesit shëndetësor; mbështetje psikologjike; këshilla dhe informacione në lidhje me të drejtat tuaja në një gjuhë që ju kuptoni; ndihmë juridike gjatë procedurës penale ose të tjera për ushtrimin e të drejtave tuaja; informacion mbi procedurat përkatëse gjyqësore ose administrative dhe të drejtën e shtetasve të huaj për të kërkuar azil; qasja në arsim; informacion në lidhje me mundësitë dhe kthim në vendin e shtetësisë, ose në një vend ku keni pasur/keni qëndrim ligjor para se të hyni në Republikën e Maqedonisë.

5.

Çfarë lloji i kujdesit ju ofrohet

Transport dhe strehim të sigurt

Transport të sigurt dhe strehim për viktimat e trafikimit, qofshin të huaj apo shtetas, është hapi i parë i ndërmarrë për të ndihmuar. Në qoftë se nuk ka strehim të sigurt dhe jeni shtetas maqedonas, do të jeni të vendosur në Qendrën për vendosjen e viktimave të trafikimit. Në këto qendra vendosen vetëm femra. Në ate ka të punësuar një ekip ekspertësh i cili do të jetë me ju dhe do t'ju ndihmojë në fuqizimin tuaj dhe shërim të duhur. Këtu ju mund të konsideroni nëse do të merrni pjesë në procedurën penale, a do të kontaktoni policinë në qoftë se ju ende nuk keni dhënë deklaratë.

Shtetasit e Maqedonisë janë të lejuar që të kthehen në shtëpitë e tyre, nëse kushtet e lejojnë atë.

Nëse nuk jeni vendas por keni qëndrim të rregulluar në Republikën e Maqedonisë do të vendoseni në Qendrën e pranimit për të huajt. Nëse ju jeni një fëmijë, qendra e Mirëqenies Sociale do të emërojë një kujdestar të përkohshëm, që në bashkëpunim me ju do të vendosë se ku do të jeni të vendosur.

Mbrojtje shëndetësore

Nëpërmjet sigurimit shëndetësor të detyrueshëm ju ofrohen shërbime shëndetësore themelore, duke përfshirë kujdesin parësor, specialist-konsultative të kujdesit shëndetësor dhe kujdes spitalor. Nëse jeni fëmijë, ju keni të drejtë në sigurim shëndetësor të detyrueshëm përmes një prind ose të një anëtarit të familjes tuaj.

Nëse jeni të vendosur në Qendrën për Viktimat e Trafikimit, Qendra për Punë Sociale nga vendi juaj i banimit është kompetent për të rregulluar të drejtën e kujdesit shëndetësor në bashkëpunim me Fondin e Shëndetësisë. Nëse ju jeni një i huaj, një viktimë e trafikimit të qenieve njerëzore dhe jeni të vendosur në Qendrën e pranimit për të huajt, keni të drejtë për mbrojtje shëndetësore në Maqedoni. Në këto strehimore (Qendra për viktimat e trafikimit ose Qendra e pranimit) ka nga një ekip ekspertësh që do të përcaktohet për shëndetin tuaj fizik dhe mendor dhe mbi bazën e këtyre të dhënave do të jeni të informuar për institucionet në të cilat ju duhet të shkoni për trajtim të mëtejshëm.

Ndihma dhe mbrojtja juridike

E drejtë themelore duhet t'ju sigurohet është qasja në ndihmë juridike. Kjo përfshin informacion mbi të drejtat dhe detyrimet të hetimit paraprak, gjatë dhe pas seancës kryesore, të drejtën për një kujdestar, përkthyes nëse jeni të huaj, ose nuk e dini gjuhën, të drejtën në periudhë për reflektim, një leje qëndrimi të përkohshme në qoftë se jeni një i huaj, mundësia e sjelljes kompensim dhe të tjera. Si të dëmtuar/dëshmitar ju kanë të drejtë për ndihmë ligjore falas gjatë procedurës.

Në rast se jeni fëmijë viktimë, keni të drejtë të jeni të përfshirë në Programin për mbrojtjen e dëshmitarëve, duke u dhënë pëlqim me shkrim nga prindi/kujdestari. Përmes këtij programi ju sigurohet ndihmë juridike falas si dhe mbrojtje. Ndihma ligjore falas dhe përfaqësim mund të jepet për ju, nëse ju jeni të përfshirë në programet për të ndihmuar dhe për të mbrojtur viktimat e trafikimit të qenieve njerëzore të përfshira nga organizatat e shoqërisë civile. Gjithashtu, ndihmën ligjore falas mund t'a kërkonti nëpër zyrat rajonale të Ministrisë së Drejtësisë, ose nëpërmjet shoqatave dhe avokatëve të qytetarëve të autorizuar që janë në regjistrin e avokatëve për të siguruar ndihmë ligjore falas.

Nëse një viktimë e trafikimit të qenieve njerëzore ka vuajtur dëme, duke përfshirë dëmtim fizik ose mendor, vuajtje emocionale, humbje materiale ose dëmtim tjetër, rrezikimin e të drejtave dhe interesave tuaja, si pasojë e një krimi keni të drejtë të kërkonit dëmshpërblim apo kërkesë pronësore-juridike për marrjen e kompensimit nga kundërvajtësit.

Mbrojtja gjyqësore

Për të ndjekur penalisht autorët e trafikimit të qenieve njerëzore është Prokurori përgjegjës publik për të ndjekur penalisht rastet e krimit të organizuar dhe korrupsionit. Përveç sanksionimit penal të dhunuesit, në procedurën penale mund të paraqesë një propozim për kërkesën pasurore juridike, nëse një viktimë e trafikimit të qenieve njerëzore kanë pësuar dëm jomonetar. Prokurori Publik duhet të mësojnë se ju keni të drejtë për të raportuar kërkesës pasurore juridike në rrjedhën e hetimeve.

Nëse gjykata vendos për kërkesën pasurore juridike në procedurë penale, mund të ju udhëzojë për të bërë të drejtën e kompensimit në procedurat civile duke parashtruar një padi.

Procedura penale për ndjekjen penale të autorëve të trafikimit.

Gjatë hetimit

Si viktimë, gjatë hetimit keni të drejtë për ti dhënë sugjerime Prokurorit të Përgjithshëm për të marrë hapa të nevojshme për të ushtruar të drejtat e juaja. Gjithashtu ju keni të drejtë në avokat falas i cili do t'ju shpjegojë të gjithë procedurën që duhet të përfshihet. Avokati ka nevojë për të dëgjuar historinë tuaj në detaje. Ai do të jetë me ju gjatë tërë procesit gjyqësor dhe do të mbrojë interesat tuaja. Gjatë hetimit keni të drejtë për të raportuar një kërkesë pasurore juridike. Në rast të ndërprerjes së hetimit ju duhet të jeni të raportuar.

Gjatë seancës kryesore

Ju keni të drejtë për të marrë pjesë në gjykim, si dhe të merrni pjesë në procedurën e provave (proponi prova dhe të tregoni faktet e veçanta). Seanca kryesore pavarësisht paditësit, të pandehurit dhe avokatit të tij, detyrimisht do të thërrasin edhe ty. Në këtë fazë, ju keni të drejtë të kërkonti kompensim ligjor. Çështjet që lidhen me jetën personale, nuk keni detyrë që të përgjigjeni nëse nuk kanë lidhje me çështjen penale. Ju keni të drejtë të flasni gjuhën e juaj amtare, dhe gjykata është e obliguar që të sigurojë një përkthyes. Ju keni të drejtë të kërkonti shqyrtimin në një dhomë të veçantë të të pandehurve dhe deklarata juaj të regjistrohesh me audio ose video. Ju gjithashtu mund të kërkonti mënjanim të publikut nga seanca kryesore. E drejta për intimitet dhe siguri si viktimë e trafikimit të qenieve njerëzore është e garantuar.

Për të gjitha këto të drejta, gjykata, prokurori publik dhe policia janë të detyruar për të të mësuar para hetimit të parë dhe për mësimet duhet të përpilohet një shënim zyrtar ose raport.

Nëse ju jeni një viktimë fëmijë të një krimi, ju keni të drejtë në mbrojtje të veçantë të sigurisë tuaj dhe atë të familjes tuaj, kujdes dhe vëmendje nga ana e autoriteteve dhe subjekteve të përfshira në procedurën penale; të drejtë në mbrojtje të veçantë nga viktimizimi sekondar dhe të drejtën për asistencë psikologjike dhe të tjera profesionale dhe mbështetje nga autoritetet, institucionet dhe organizatat për të ndihmuar fëmijët viktimë të krimeve.

Ju keni të drejtë të jeni të informuar për të drejtat tua në një gjuhë të kuptueshme dhe të duhur sipas moshës, dhe të respektohet e drejta e privatësisë. Prindërit/prindi ose kujdestari/kujdestarja duhet të jenë të informuar për të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me veprën penale në lidhje me të dyshuarit, të akuzuarit dhe të dënuarit. Ju ose prindërit tuaj/prindi ose kujdestari/kujdestarët keni të drejtë të merrni pjesë në procedurën penale si palë e dëmtuar duke u bashkuar

me ndjekjen penale ose për qëllime të kërkesës për dëmshpërblim për dëmet. Policia, prokurori dhe gjykata do të veprojnë drejt teje me kujdes të veçantë, duke marrë parasysh interesat tuaja kur të marrin një vendim për ndjekjen penale të të pandehurit për të cilën gjë hartohet një shënim zyrtar ose raport.

Ekzekutimi i gjykimit

Sapo keni marrë vendimin, ju keni të drejtë për të përfutur shpërblim financiar me kërkesën tuaj pronësore juridike. Nëse ju jeni një i mitur, aplikohet në Ministrinë e Drejtësisë për kompensim. Nëse ju jeni në moshë atëherë mbledhja do të kryhet nga përmbaruesi në procedurat e ekzekutimit.

Mbrojtja sociale

Shërbimet sociale do të ofrohen nga ekspertë të Qendrës për Punë Sociale. Në qendër ju mund të merrni këshilla për shërim të shpejtë, ndihma në krijimin e kontakteve me familjen tuaj, si dhe ndihmë në sigurimin e dokumenteve personale (certifikatën e lindjes, kartë identiteti, karta e sigurimeve shoqërore, etj). Në mënyrë që të sigurohen disa nga përfitimet në para të gatshme për ndihmë sociale (ndihmë financiare njëherëshe, ndihmë sociale, ndihmë financiare, ndihmë për ndihmë dhe përkujdesje, përkrahjen e fëmijëve, etj) duhet të dorëzoni dokumentacionin përkatës në lidhje me paaftësinë tuaj për të ardhurat, vetë-furnizim dhe mjetet e jetesës. Qendra për punë sociale mund të ju ofrojë ndihmë humanitare për të plotësuar nevojat themelore të tilla si ushqim, veshje, këpucë dhe tualetin. Kjo mundet të sigurohet nga shoqatat qytetare që ofrojnë shërbime sociale.

Arsimim

Arsimi fillor dhe i mesëm është i detyrueshëm në Maqedoni dhe në qoftë se ju keni ndërprerë arsimin tuaj keni të drejtë të informoheni për përfshirjen ose përfundimin e arsimit formal. Ju mundeni që në mënyrë aktive të bashkoheni në procesin arsimor në varësi të moshës. Nëse ju nuk e keni përfunduar arsimin fillor, dhe je në moshë më të vjetër se moshja e moshja kualifikuese për të vizituar klasat e rregullta, keni mundësinë për të vazhduar shkollimin në shkollë për të rritur. Nëse ju keni përfunduar arsimin fillor, mund të bashkangjiteni në një shkollë të rregullt profesionale dhe në Universitetin e Punëtorëve. Ju gjithashtu mund të përfshihenit në programin për trajnim profesional, edhe pse nuk keni përfunduar arsimin fillor, por me një angazhim krahas formimit profesional për të përfunduar arsimin fillor. Shërbimet psikologjike-pedagogjike në shkollat kanë detyrim për të të ofruar vazhdimisht mbështetje gjatë shkollimit. Shoqatat e qytetarëve për të mbështetur viktimat e trafikimit me qenie njerëzore mund t'ju ndihmojnë në sigurimin e dokumentacionit të nevojshëm për regjistrim në shkollë, dhe gjithashtu mund t'ju ndihmojë edhe gjatë regjistrimit.

Punësim

Nëse jeni të papunë dhe ke arritur 15 vjet, mund të regjistroheshi në Agjencinë për Punësim, ku ju mund të merrni informacion në lidhje me të drejtat tuaja, obligimet dhe mundësitë për punësim si viktimë e trafikimit. Nëse ju jeni një i huaj, një viktimë e trafikimit të qenieve njerëzore, ka tre kushte që duhet të plotësohen për të qenë në gjendje për t'u punësuar në Republikën e Maqedonisë, të cilat janë: të keni një leje pune, qëndrim të rregulluar për të huajt në vend dhe punësimin të rregulluar.

Gjithashtu, shoqatat e qytetarëve mund t'ju ndihmojnë në sigurimin e informacionit mbi mundësitë e punësimit në kuadër të këshillimit individual për viktimat. Gjithashtu shoqatat e qytetarëve organizojnë punëtori alternative që mund t'ju ndihmojnë të mësoni se si të shkruani biografinë tuaj, letër hapëse, aplikim për punë, çfarë dokumente ju duhet të përgatisni ose t'ju përgatisin për intervistë pune.

Riintegrimi

Nëse ju jeni një shtetas/e i/e huaj, keni të drejtë në kthimin e sigurt në vendin tuaj amë. Kjo përfshin vlerësimin e rrezikut dhe të sigurisë për kthimin tuaj dhe të familjes tuaj. Nëse është përcaktuar se kthimi nuk paraqet një kërcënim për sigurinë tuaj, pastaj shoqatat e qytetarëve dhe organizatave ndërkombëtare do të ndihmojnë në organizimin dhe ofrimin e biletit të udhëtimit. Në rast të një të mitur, udhëtimi do të jetë i bërë me presence të një kujdestari të përkohshëm.

Nëse ju jeni një fëmijë dhe shtetas maqedonas, vendimi për qëndrim të përhershëm do të sjellë punëtorin social i detyruar nga Qendra kompetente për punë sociale. Vendimi duhet të bëhet me bashkëpunimin tuaj. Përpara se të vendosë në lidhje me vendin e banimit duhet të ketë parasysh sigurinë tuaj, të gjitha gjërat që janë në interesin tuaj dhe mundësitë për vetë-avancimin tuaj. Nëse nuk ka kushte për kthimin me prindërit tuaj, punonjësi social do të gjen mënyrë për të të akomoduar në vendin më të përshtatshëm. Punonjësi social duhet t'ju tregon të gjitha mundësitë dhe shërbimet që mund t'i merrni në vendin e ardhshëm të banimit.

Rreth nesh...

Shoqata për veprim kundër dhunës dhe trafikimit - Porta e Hapur/ La Strada Maqedoni është një organizatë kombëtare joqeveritare plotësisht e angazhuar në luftën kundër trafikimit me qenieve njerëzore. Që nga fillimi i tij në vitin 2000 e deri më sot Porta e Hapur tërësisht trajton çështjen e trafikimit të qenieve njerëzore dhe merr pjesë në mënyrë aktive në ndërtimin e politikave dhe strategjive në mënyrë që të zvogëlojë numrin e viktimave të trafikimit dhe të sigurojë një trajtim më të mirë për personat e trafikuar. Porta e Hapur drejton një strehë për strehimin e viktimave të trafikimit dhe ofron shërbime për riintegrim të suksesshëm; Ajo jep informacion në lidhje me problemin e trafikimit me qenie njerëzore dhe mënyrat e parandalimit nëpërmjet një linje telefonike e cila është falas për telefonuesit nga Maqedonia.

6.

Kontaktet nga institucionet relevante dhe organizatat për ndihmë dhe përkrahje për viktimat e trafikimit:

Shoqata për veprim kundër dhunës dhe trafikimit - Porta e Hapur

SOS linja telefonike falas!

0800 11 111; 02 27 00 107

www.lastrada.org.mk • email: lastrada@lastrada.org.mk

Ministria e Politikës së Punës dhe Çështjeve Sociale - Mekanizmi kombëtar për referimi të viktimave të trafikimit

Tel: 02 310 6443

Në përgatitjen e udhëzuesit morri pjesë:
Shoqata për veprim kundër dhunës dhe trafikimit - Porta e Hapur





Shoqata për Emancipim,
Solidaritet dhe Barazi të Grave
www.esem.org.mk

ESSE